



PLANI VENDOR I VEPRIMIT TË RINISË

BASHKIA SARANDË

2024-2027

Nëntor 2023



Financuar nga
Bashkimi Evropian



Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 – ReLOaD2, financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Plani Vendor i Veprimit të Rinisë, është hartuar në kuadër të projektit "Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor 2 - ReLOaD2", i cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Përmbajtja e tij, është përgjegjësi e Mary Ward Loreto dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian (BE) ose Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

PËRMBAJTJE

HYRJE.....	5
QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR RININË.....	6
METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR RININË.....	9
PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE PËR RININË.....	10
ANALIZA SWOT.	15
PLANI I VEPRIMIT.....	17
MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT.	26



HYRJE

Bashkia Sarandë kufizohet në veri me Bashkitë Himarë dhe Delvinë, në jug me Bashkinë Konispol, në lindje me Bashkinë Finiq dhe në perëndim me detin Jon. Saranda është një qytet në Shqipërinë jugore, e vendosur në një reliev të pjerrët, që zbret në gjirin e detit Jon.

Saranda është një qytet me më shumë se 2,000 vjet histori, ngritur në zonën e bregdetit jugor të Shqipërisë, e pasur me vlera të rralla në trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike shqiptare, por edhe evropiane. Në kuadër të Reformës Territoriale, Bashkia Sarandë ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në sipërfaqe, në territore dhe në popullsinë e saj, ku veçori kryesore është dhe bashkimi i territorit të Njësisë Administrative të Ksamilit me të. Bashkia Sarandë përbëhet nga qyteti i Sarandës, qyteza e Ksamilit, si dhe nga fshatrat Çukë, Metoq, Gjashtë dhe Shelegar.¹ Bashkia Sarandë regjistron një popullsi prej rreth 56,534 banorë, nga këta 47,400 banorë nga qyteti i Sarandës dhe 9,134 banorë nga qyteza e Ksamilit. Bashkia Sarandë përbëhet nga dy Njësi Administrative, ajo e Sarandës dhe e Ksamilit, të shtrira në një sipërfaqe prej 58.96 km².²

Bashkia Sarandë synon të nxisë zhvillimin e një rinie aktive dhe të shëndetshme, që mund të luajë një rol kryesor në zbatimin e të Drejtave për Rininë dhe Zhvillimin Ekonomik-Kulturor të qytetit. Deri më sot, ka munguar një plan në nivel vendor i dedikuar për të rinjtë, për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në jetën politike, ekonomike dhe sociale, mundësive dhe shanseve të barabarta. Vizioni i Bashkisë Sarandë për përparimin e të rinjve si qytetarë aktivë dhe vendimmarrës, me qëllim plotësimin e nevojave të tyre në arsim, shëndetësi, shërbime kulturore, sociale, recreative, do të materializohet në këtë plan konkret, i cili do të monitorohet, dhe do të vlerësohet vazhdimisht për të analizuar arritjen e qëllimeve dhe objektivave për angazhimin rinor, si edhe çfarë duhet përmirësuar për rritje të cilësisë dhe efektivitetit në shërbimet rinore.

Bashkia Sarandë me mbështetjen e Fondacionit Mary Ward Loreto, hartoi Planin Vendor të Veprimit për Rininë 2024-2027, në funksion të Këshillit Vendor Rinor, të miratuar në Këshillin Bashkiak me vendim nr. 9, datë 27.01.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e

¹ Faqja zyrtare, Bashkia Sarandë: <https://bashkiasarande.gov.al/profili-i-bashkise/>

² Plani Social, Bashkia Sarandë 2023-2025, fq 11.

Këshillit Vendor Rinor pranë Bashkisë Sarandë”³. Plani Vendor i Veprimit për Rininë është dokumentimi i bashkëpunimit, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me të rinjtë, dhe aktorët kyç të komunitetit për identifikimin e nevojave dhe problematikave me të cilat përballen të rinjtë. Ky plan veprimi, i cili kërkon ndërhyrje në sektorin e të rinjve është një plan i propozuar nga vetë të rinjtë. Plani Vendor i Veprimit të Rinisë, në Bashkinë Sarandë është një dokument që do të udhëheqë bashkinë, komunitetin, ofruesit e shërbimeve rinore dhe palët e tjera të interesuara për të përmbushur nevojat e të rinjve të Sarandës.

³ Vendim i Këshillit Bashkiak Sarandë https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2023/02/vkb_sr_9.pdf

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR RININË

Vizioni i Bashkisë Sarandë synon krijimin e kushteve dhe mjedisit të sigurt social dhe politik, për një rini aktive dhe të barabartë në të gjitha fushat e jetës për të ardhmen e tyre. Prioritet do të jetë përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë së jetës së të rinjve dhe forcimi i statusit të tyre, përmes zhvillimit të më shumë mundësive në edukim, punësim, shëndetësi, kulturë dhe rritjen e pjesëmarrjes së plotë të të rinjve në shoqëri dhe vendimmarrje.

Vizioni i këtij Plani Vendor të Veprimit për Rininë është të fuqizojë sektorin rinor nëpërmjet ngritjes së një mekanizmi efektiv dhe transparent që mundëson pjesëmarrjen e të rinjve, jo vetëm në fazën konsultative e përgatitore të politikave rinore në Bashkinë Sarandë, por gjithashtu në implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e Planit Vendor të Veprimit për Rininë.

Plani Vendor i Veprimit për Rininë synon:

- Të identifikojë problemet, nevojat dhe prioritetet e të rinjve të Sarandës.
- Të propozojë zgjidhjet e mundshme ose fushat e ndërhyrjes, nëpërmjet mënyrave, mekanizmave dhe mjeteve të caktuara për të adresuar problematikat e dala.

Nga konsultimet midis të rinjve dhe pikave kyçe të komunitetit në Bashkisë Sarandë, takimeve dhe pyetësorëve të realizuar me të rinjtë në Sarandë, kanë dal si prioritet këto fusha⁴:

1. Hapësirë dhe infrastrukturë rinore e sigurt.⁵
2. Vullnetarizmi, dhe edukimi joformal i të rinjve.
3. Orientimi profesional, punësimi dhe sipërmarrja rinore.
4. Zbulimi i talenteve rinore (art, sport, kulturë, mjedis, turizëm dhe teknologji) dhe edukimi në TIK.
5. Çështjet sociale, shëndetësore dhe shërbimet publike për të rinjtë.
6. Pjesëmarrja dhe përfaqësimi rinor në politikë dhe vendimmarrje.

Tre qëllimet kryesor mbi të cilat bazohet Plani Vendor i Veprimit për Rininë, në Bashkinë Sarandë janë:

-  Të fuqizojë shërbimet rinore në nivel lokal duke përmirësuar shërbimet ekzistuese, si edhe duke ofruar shërbime të reja në hapësirë dhe infrastrukturë rinore, sipas nevojave të rinisë në të gjithë territorin e Bashkisë Sarandë. Politikat rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirëfinancuar.

⁴ Bazuar në rezultatet e pyetësorëve të realizuar rreth aktiviteteve dhe fushave që duan të marrin pjesë të rinjtë (pyetësorët e realizuar në Tetor 2023 në shkollat e Sarandës dhe Ksamilit, si edhe konsultimet me pikat kyçe në komunitet).

⁵ Bazuar në gjetjet nga konsultimet e bëra me të rinjtë, dhe emrtuar sipas përcaktimit në Ligjin Nr.75 Datë 4.11.2019 Për Rininë.

- ✚ Të rejat dhe të rinjtë të marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe të ndihen të fuqizuar për t'u shprehur në zërin e tyre. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rinjve në të gjithë diversitetin e tyre.
- ✚ Të mbështesë rritjen e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor dhe edukimit joformal, duke rritur dhe përmirësuar mundësitë për të hyrë në tregun e punës.

Objektivat sipas prioriteteve:

✚ **Prioriteti 1**

- **Objektivi 1.1:** Ndërtimi i një qendre multifunksionale për të rinjtë që përfshijnë të gjitha grupet vulnerable të të rinjve, dhe përmirësojnë cilësinë e jetës së të rinjëve. Krijimi, mirëfunksionimi dhe mirëmenaxhimi i hapësirave dhe mundësive, ku të rinjtë të ushtrohen në art, kulturë, sporte dhe forma të tjera rekreative.
- **Objektivi 1.2:** Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në funksion të rinisë.

✚ **Prioriteti 2:**

- **Objektivi 2.1:** Krijimi i një mjedisi mundësues në nivel vendor ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e rinisë aktive.

✚ **Prioriteti 3:**

- **Objektivi 3.1:** Zhvillimi i aftësive dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për të përfunduar profilizimin, trajnimin e mëtejshëm ose integrimin në tregun e punës.

✚ **Prioriteti 4:**

- **Objektivi 4.1:** Përfshirja e të rinjve në dizenjimin dhe zbatimin e aktiviteteve në fushën e artit, kulturës, sportit dhe mjedisit.

✚ **Prioriteti 5:**

- **Objektivi 5.1:** Përmirësimi i rezultateve të shëndetit fizik dhe mendor të të rinjve, duke u fokusuar në nevojat e identifikuara.
- **Objektivi 5.2:** Përmirësimi i rezultateve të mirëqenies emocionale të të rinjve dhe fuqizimit të të rinjve për të kërkuar ndihmë.

✚ **Prioriteti 6**

- **Objektivi 6.1:** Rritjen e pjesëmarrjes rinore në vendimmarrje lokale nëpërmjet përfshirjes së tyre në Bordet Këshillimore të Bashkisë, shkollave dhe forumeve rinore.
- **Objektivi 6. 2:** Rritja e kapaciteteve rinore në funksion të demokracisë dhe përfshirjen e tyre në programe të shkëmbimit ndërsektorial.

METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR RININË

Metodologjia e përdorur për hartimin e Planit të Veprimit konsiston në realizimin e një procesi nga vetë të rinjtë, nën monitorim dhe mbështetjen e stafit të organizatës Mary Ward Loreto për ndjekjen e metodologjisë dhe lehtësimin e procesit, dhe me konsultimin me aktorët kyç në komunitet dhe Bashkinë Sarandë si: Drejtuesit e Shkollave të Mesme në qytetin e Sarandës dhe Ksamilit, mësues dhe psikologë në këto shkolla, Administratoren e Njesisë Administrative Ksamil, Shefen e Kabinetit në Bashkinë Sarandë, Drejtoren e Kujdesit Social, Drejtoren e Arsimit dhe Administrimit Financiar.

Hapi i parë u fokusua në përgatitjen dhe hartimin e të gjithë punës së nevojshme për hartimin e planit të veprimit, për të identifikuar nevojat, shqetësimet dhe problemet me të cilat përballen të rinjtë në Sarandë. Gjatë kësaj faze u zhvilluan 200 pyetësorë me të rinjtë në Gjimnazin “Hasan Tahsini”, Shkollën Ekonomike “Antonio Athanas” Sarandë dhe Shkollën e Mesme të Bashkuar “5 Dëshmorët” Ksamil, prej të cilave u nxorrën prioritetet më të theksuara nga të rinjtë. Në hapin e dytë Këshilli Rinor Vendor zhvilloi analizën SWOT⁶, duke nxjerrë në pah prioritetet e të rinjve, problematikat dhe hapat konkretë për vijim.

Një peshë kryesore gjatë hartimit të Planit të Rinisë, morën dhe konsultimet me drejtuesit e komunitetit, ku të rinjtë e Këshillit Rinor patën mundësi të diskutojnë për çështjet që lidhen me ata drejtpërdrejt, planin e tyre të aktiviteteve dhe misionin e tyre. Metodologjia e planit është fokusuar në veprime konkrete nga të rinjtë, për të fituar një praktikë të mirë për të folurit në publik. Të rinjtë morën sugjerime dhe këshilla, të cilat janë integruar në zhvillimin e planit të tyre.

Pas këtij hapi, në bashkëpunim me Bashkinë e Sarandës u integrua ky dokument plan me dokumentet/politikat përkatëse të bashkisë, për të ofruar bashkëpunim të mundshëm me drejtorin të ndryshme pranë Bashkisë, për të adresuar realizimin e prioritetëve të vendosura nga të rinjtë. Përgatitja e planit u krye duke u bazuar në indikacionet e strategjitë evropiane e atyre kombëtare për rininë, duke ruajtur padyshim këndvështrimin lokal në analizën e gjendjes dhe përcaktimin e problematikave rinore. Kësisoj edhe përcaktimi i rekomandimeve dhe i hapave që duhen ndërmarrë bazohet në respektimin e të tre dimensioneve të sipërpërmendura.

⁶ Klein F, Pelzer U, Schmuck RB, Malinka T, Felsenstein M, Denecke T, Pratschke J, Bahra M. Strengths, Weaknesses, Opportunities, and Threats of Centralized Pancreatic Surgery. 2019 Mar;23(3):492-502.

PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE PËR RININË

Qeveria e Shqipërisë e shikon situatën me të rinjtë si një mundësi për zhvillim dhe vënien e rinisë në qendër të zhvillimit. Pikërisht për këtë gjë u krijua një portofol, ministri shteti përgjegjës për rininë dhe fëmijët.⁷ Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029, është dokumenti bazë mbi të cilën hartohen planet lokale dhe synon të përmirësojë situatën e të rinjve në Shqipëri. Kjo strategji është një bazë orientimi për pushtetin vendor, të rinjtë dhe organizatat e shoqërisë civile, e cila është integruar edhe në planin tonë të veprimit. Strategjia e OKB-së për Rininë 2030 mbështetet në vizionin global të një botë, ku të drejtat njerëzore të çdo të reje dhe të riu bëhen realitet; ku sigurohet se çdo e re apo i ri fuqizohet për të arritur potencialin e vet të plotë; dhe që e njeh kapacitetin, qëndrueshmërinë dhe kontributet pozitive të të rinjve si agjentë të ndryshimit.⁸

Objektivat strategjikë të Strategjisë së Rinisë së Këshillit të Evropës synojnë të rrisin angazhimin dhe pjesëmarrjen e të rejave dhe të rinjve në proceset demokratike, forcimin e të Drejtave të Njeriut dhe në vendimmarrje. Këshilli i Evropës në dokumentin e tij strategjik për rininë ka synuar këto prioritetet tematike: - rigjallërimi i demokracisë pluraliste; - akses i të rinjve në të drejtë; - jetesa e përbashkët në shoqëri gjithëpërfshirëse; - puna rinore.⁹

Çështjet që kanë të bëjnë me rininë, në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022–2024, i shikojnë në aspektin e bashkëpunimit dhe integritetit rajonal dhe tema si: “Investimi te rinia në të ardhmen evropiane”, kanë marrë prioritet në proceset e asociim-stabilizimit dhe integritetit me Bashkimin Evropian.¹⁰

Programi Kombëtar i Praktikave të Punës synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese, që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike në njohje me sistemin administrativ publik.¹¹ Çdo vit edhe Bashkia Sarandë, nxjerr sipas detyrimit ligjor vendet e lira për praktikantët e punës, duke shtuar një tjetër shërbim për të rinjtë e Sarandës.

Agjencia Kombëtare e Rinisë, nëpërmjet fondit grant të dedikuar për rininë, të miratuar në ligjin vjetor të buxhetit, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore organizatat për të rinjtë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.¹² Bashkia Sarandë, ende nuk ka një zë specifik në buxhet të dedikuar vetëm për rininë, por nëpërmjet projekteve të ndryshme ajo i ka përfshirë të rinjtë në aktivitete në fusha të ndryshme.

⁷ Vendim Nr.692 datë 26.10.2022 për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë-2022-2029 dhe Planit të Veprimit, fq2

⁸ https://www.un.org/youthenvoy/wp-content/uploads/2018/09/18-00080_UN-Youth-Strategy_Web.pdf

⁹ Për më shumë informacione shikoni këtë faqe: Result details (coe.int).

¹⁰ Vendim Nr. 692, date 26.10.2022, për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

¹¹ Vendimi Nr.395 date 29.04.2015, për Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, fq.1

¹²Vendim nr. 566, datë 29. 07.2022, Neni 1, Fondi grant për rininë.

Në nivel vendor, Bashkia e Sarandës në vijim të Ligjit nr. 75/2019 “Për Rininë”, dhe sikurse është cituar në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 se: *“Strategjia Kombëtare për Rininë 2022 – 2029 do të jetë dokumenti ku do të bazohen politikat për aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve. Ky dokument do të synojë hartimin e politikave rinore kombëtare integruese, për adresimin e problemeve të ndryshme me të cilat përballen sot të rinjtë e që lidhen me sfidat që ata ndeshin.”*¹³, por edhe si detyrim i qeverisjes vendore bazuar në Ligji nr.75, datë 04.11.2019 Për rininë, neni 7, për njësitë e vetëqeverisjes vendore e ka përfshirë në fokus dhe axhendën e saj rininë, më konkretisht në Planin Social 2023-2025¹⁴ duke shprehur:

1. Zhvillimin e shërbimeve egzistuese:

- Plotësimi me staf social, riorganizimi dhe menaxhimin financiar i Qendrës Multifunkzionale – ambiente të përshtatshme dhe materiale që ndihmojnë në zhvillimin e aktiviteteve psiko -sociale si dhe personel – ku ofrohen shërbime të integruara për të gjitha kategorite vulnerabël, si për fëmijët dhe të rriturit.
- Pasurimi me shërbime të trajtimit të personave me aftësi të kufizuara, terapi zhvillimi, terapi okupacionale, shërbime rehabilitimi dhe shërbime në shtëpi përmes angazhimit të specialistëve të fushës, të cilët mund të ofrojnë shërbime të lëvizshme dhe/ose në ambiente të përshtatshme për të rinjtë nga mosha 16 -21 vjeç.

2. Zhvillimin e shërbime të reja:

- Ngritja e një qendre rinore dhe funksionimi për aktivizimin e të rinjve në nivel Bashkie dhe Njësie Administrative.¹⁵

Gjithashtu, Bashkia Sarandë po punon aktualisht për ngritjen e një platforme për vullnetarizmin, për ta bërë përfshirjen e të rinjve më aktive, si edhe për t’u dhënë zë iniciativave rinore.¹⁶

Në nivel vendor, Bashkia e Sarandës ka nisur punën e saj drejt realizimit të detyrimeve ligjore duke arritur të ketë një Këshill Vendor Rinor të miratuar nga Këshilli Bashkiak, por mbetet ende shumë për t’u bërë për infrastrukturë rinore dhe buxhetim rinor.¹⁷ Këshilli vendor i rinisë është organ këshillimor, që funksionon pranë Kryetarit të Bashkisë.

¹³ Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 (faqe 408),

¹⁴ Vendim Këshillit Bashkiak Nr.128-Datë 21.10.2022 për miratimin e Planit Social 2023-2025.

¹⁵ Plani social, Bashkia Sarandë, 2023-2025, fq 18.

¹⁶ Informacion gjatë konsultimeve me personat kyc në Bashki.

¹⁷ Vendim Nr. 9, datë 27.01.2023 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Këshillit Vendor Rinor pranë Bashkisë Sarandë”

ANALIZIMI I SITUATËS AKTUALE

Programet e zhvilluara deri më tani nga Bashkia Sarandë me fokus të rinjtë përfshijnë aktivitete të ndryshme siç janë: Programi Kombëtar i Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore, e cila ofron praktika profesionale me stimuj financiarë, e implementuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale, Zyra e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Sarandë dhe zbatuar nga Bashkia Sarandë. Aktivitete sportive dhe argëtuese për të rinjtë, ku janë organizuar nga Bashkia projekte të ndryshme. Pjesë e aktiviteteve, ku është angazhuar rinia kanë qenë dhe aktivitetet për nxitje të vullnetarizmit duke i angazhuar të rinjtë në organizimin e eventeve festive të realizuara gjatë vitit nga Bashkia. Përfshirja e të rinjve me nevoja të veçanta, nëpërmjet aktiviteteve të Qendrës për Zhvillimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, Qendra e emergjencës për viktimat e dhunës me bazë gjinore përfshirë dhe fëmijët.

Në Bashkinë Sarandë nuk ka një punonjës apo njësi të dedikuar për rininë, por pranë Bashkisë funksionon Drejtoria e Projekteve, Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, e cila implementon projekte të cilat kanë në fokus rininë. Në Bashkinë Sarandë, rinia nuk buxhetohet si një program më vete, por si pjesë e programeve dhe aktiviteteve brenda Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Shërbimit Social. Shikohet se është shumë e rëndësishme shtimi i një punonjësi të dedikuar rinisë nga Bashkia Sarandë.

Rinia e Bashkisë Sarandë, po e gjen veten të papërgatitur profesionalisht për vendet e punës, të cilat po shtohen për shërbimet gjatë sezonit turistik. Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç është 56,7%.¹⁸ Shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç është 22,3 %. Të rinjtë e moshës 15-29 vjeç që deklaruan se janë nxënës/studentë ose në trajnim përbëjnë 71,6 % të të rinjve ekonomikisht joaktivë. Ndërsa të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ekonomikisht joaktivë, 2,6 % klasifikohen si të papunë, të dekurajuar.¹⁹

Ndërkohë situata aktuale e nxjerrë nga pyetësorët më të rinjtë paraqitet si më poshtë:

- 65% e të rinjëve ndjekin shkollën e mesme, dhe 35% prej tyre ndjekin shkollë profesionale.
- 83% janë përgjigjur se i përkasin grupëmoshës 15-19 vjeç, dhe 17% i përkasin grupmoshës 19-23 vjeç.
- 60% e të rinjve që kanë plotësuar pyetësorët janë meshkuj dhe 40% janë femra.
- Për të rinjtë e Sarandës tre burimet kryesore ku informohen se kush ofron mundësi për angazhimin e të rinjëve në qytet janë: e para është shkolla, e dyta është bashkia, dhe e treta janë bizneset private.
- Ndërkohë vetëm 31 % janë përgjigjur se, po, janë angazhuar me institucionet e mësipërme. Tre arsyt kryesore të listuara prej të rinjve se pse janë të kënaqur nga

¹⁸ Instat- Anketa Tremujore e Forcave të Punës, T2 - 2023

¹⁹ Instat

pjesëmarrja në këto aktivitete janë: kontaktet e reja me shumë njerëz, rrjetet e ri, përgatitje për punë në të ardhmen, përvojat e shkëmbimit kulturor.

- 79% shprehen se i ka ndihmuar shkolla për përfshirje në aktivitetet rinore.
- Tri fushat kryesore, ku të rinjtë janë shprehur se duan të aktivizohen janë: 23% për të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, 20% për promovim të vullnetarizmit dhe 19.5 % për sporte dhe ushtrime, më pas vijon fushat e tjera më pak të përmendura prej tyre.
- Tre aktivitete kryesore, ku të rinjtë duan të përfshihen janë: vullnetarizëm (24 %), zbulimi i talenteve rinore dhe zhvillimi i tyre (20%), nxitja e novacionit (14%).
- 64% e të rinjve shprehen se duan të aktivizohen gjatë vitit shkollor, 14% gjatë pushimeve verore, dhe vetëm 22% gjatë gjithë vitit.
- Pesë fushat kryesore të cilat kanë listuar të rinjtë si më të preferuarat për t'u aktivizuar janë: të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, promovim i vullnetarizmit, sport/ushtime, edukim, dhe start-up.
- Tri arsyt kryesore të listuara nga të rinjtë të cilat mund të ndihmojnë në rritjen e aktivizimit rinor janë: nëse e kuptojnë që do t'i ndihmonte ata për të përmirësuar aftësitë e tyre, nëse e kuptojnë që mund t'i kenë shpenzimet e paguara, nëse shkollat dhe institucionet e tjera do t'i mbështesnin.
- Tri mënyrat më të mira për të publikuar mundësitë e përfshirjes rinore sipas të rinjve janë: rrjetet sociale, takimet ballë për ballë/ fizike, takimet informuese/ prezantim në shkolla/ universitete.
- Tre faktorët kryesorë ndikues në mos angazhimin e të rinjve në Qytetin e Sarandës janë: nuk kanë besim se angazhimi i tyre do të ketë ndikim në institucionet publike, të rinjtë nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, mungesë e vullnetit personal.
- Vetëm 18% e të rinjve e konsiderojnë veten aktiv në sferën publike për çështje që shqetësojnë rininë e qytetit.
- 79 % e të rinjve shprehen se e konsiderojnë prindin si modelin më të mirë për ta ndjekur, 13% një mësues/e, dhe 8% nuk e dinë.

ANALIZA SWOT

Analiza SWOT në praktikë kontribuon në përdorimin e duhur të mjeteve të shkëlqyera strategjike, veçanërisht ato që tashmë janë të njohura në mbarë botën.²⁰ Analiza SWOT është një metodë planifikimi e strukturuar që përdoret gjerësisht për të evidentuar dhe vlerësuar pikat e forta (Strengths), pikat e dobëta (Weaknesses), mundësitë (Opportunities) dhe rreziqet/ sfidat (Threats) e një projekti, çështjeje, territori, etj. Gjatë hartimit të këtij Plan Veprimi, kjo metodë u përzgjedh si një instrument mjaft praktik dhe i dobishëm për të analizuar situatën ekzistuese, analizë mbi bazën e të cilës u hartuan qëllimet dhe objektivat strategjike. Pikat e dobëta dhe pikat e forta evidentojnë çështje shqetësuese të të rinjve brenda territorit të Bashkisë Sarandë, të cilat mund të adresohen nëpërmjet politikave vendore, ndërsa mundësitë dhe sfidat u përkasin aspekteve të jashtme, kontrolli i të cilave mund të kërkojë bashkëpunim ndërvendor apo angazhim të qeverisë vendore e më gjerë.

Analiza SWOT

Pikat e forta/Strengths	Pikat e dobta/Weaknesses
✚ Pasuritë kulturore dhe resurset natyrore. ✚ Orientimi i zhvillimit të ekonomisë drejt turizmit dhe teknologjisë. ✚ Prania e donatorëve, organizatave të ndryshme dhe investitorët. ✚ Ekzistenca e Këshillit Vendor Rinor. ✚ Vende të reja pune në sektorin e shërbimeve dhe ato prodhuese. ✚ Ekonomi me rritje të qëndrueshme. ✚ Projekte të ndryshme për turizmin dhe çështje mjedisore. ✚ Nismat innovative.	✚ Mungesa e hapësirave dhe infrastrukturës rinore. ✚ Mungesa e planit vendor të veprimit për Rininë. ✚ Mungesa e organizatave rinore. ✚ Nivel i ulët i angazhimit rinor/ vullnetit personal. ✚ Mungesa e edukimit joformal. ✚ Priorizimi jo i duhur i rinisë në raport me sektorët e tjerë të jetës social-ekonomike në bashki.
Mundësitë/Opportunities	Kërcënimet/ Threats
✚ Nxitje e vullnetarizmit. ✚ Mbështetje me orientim profesional dhe kualifikime. ✚ Bashkëpunim me organizatat që përfshijnë rininë. ✚ Nxitja e novacionit dhe talentet e reja. ✚ Krijimi i organizatave rinore.	✚ Fondet për rininë. ✚ Pjesëmarrje e ulët në vendimmarrje e të rinjëve. ✚ Mospërfshirja e të rinjve në vendimmarrje. ✚ Mungesa e fondit të veçantë në buxhetin e Bashkisë. ✚ Ikja e trurit/ emigrimi i të rinjve.

²⁰Rynes et al., 2001; Bridgman et al., 2019, de Man et al., 2022

✚ Interesim i vazhdueshme nga investorët. ✚ Mundësi financimi nga Agjensia Kombëtare e Rinisë për Projektet në nivel vendor.	✚ Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm, shpopullimi i fshatratve dhe largimi i të rinjëve nga qytetit. ✚ Ndikimi i faktorëve socialë dhe ekonomikë. ✚ Mungesa e mjeteve teknologjike.
---	--

PLANI I VEPRIMIT

1. HAPËSIRË DHE INFRASTRUKTURË RINORE E SIGURT²¹					
Objektivi 1: Ndërtimi i një qendre rinore për të rinjtë që përfshinë të gjithë grupet vulnerable të të rinjve, dhe përmirëson cilësinë e jetës së të rinjve. Krijimi, mirëfunksionimi dhe mirëmenaxhimi i hapësirave dhe mundësive që të rinjtë të ushtrojnë art, kulturë, sporte dhe forma të tjera rekreative.					
<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Afatet</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financimi nga Bashkia (Lek)</i>	<i>Fonde/Financim nga Donator/organizata të ndryshme.</i>
1.1.1 Ngritja e Qendrës Rinore në Bashkinë Sarandë.	-Bashkia -Ministrit -Donatorë të ndryshëm -OJF	2024-2027	- Hapja e qendrës dhe funksionaliteti i saj.		Nëpërmjet aplikimeve për projekte.
1.1.2 Punësimi i një specialisti për rininë.	-Donatorë -OJF -Drejtoria e personelit	2024 (Çdo vit)	- Emërimi i një personi përgjegjës për rininë.		
1.1.3Krijimi i Klubeve rinore: Klubi i teatrit; Klubi social; Klubi i multimedias; Klubi i mjedisit; etj.	-Bashkia - Donat or OJF -Qendra kulturore dhe shumë sporte.	2024-2027	-Numri i të rinjve të angazhuar. -Numri i aktiviteteve të realizuara.		
1.1.4 Ambjente të aksesueshme për personat PAK.	-Bashkia Donatorë OJF - Drejtoria e Shërbimeve	2024 - 2007	- Sigurimi i rampës.	500 000	

²¹ Prioriteti 1.

Objektivi 2: Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore në funksion të rinisë.

1.2.1 Trajnime për rritjen e kapaciteteve të stafit të dedikuar për rininë.	-OJF -Drejtoria e personelit	2024 (Çdo vit)	-Numri i trajnimeve të zhvilluara. -Numri i pjesëmarrësve Në këto trajnime.		OJF
1.2.2Trajnime për anëtarët e Këshillit Vendor Rinor për t'u përditësuar me ligjet dhe strategjitë e reja rinore.	-OJF -Ministri i shtetit për rininë dhe fëmijët. -Drejtoria e personelit.	2024 (Çdo vit)	- Numri i trajnimeve të zhvilluara. -Numri i pjesëmarrësve .		OJF

2. VULLNETARIZMI DHE EDUKIMI JOFORMAL PËR TË RINJTË²²

Objektivi 1: Krijimi i një mjedisi mundësues në nivel vendor ku vullnetarizmi inkurajohet, mbështetet, njihet si mekanizëm kyç për nxitjen e rinisë aktive.

<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financi mi</i>	<i>Fonde/Financim nga Donator/organizata të ndryshme.</i>
2.1.1 Fushata ndërgjegjësimi me të rinjtë dhe komunitetin mbi rëndësinë e vullnetarizmit.	-Bashkia -OJF -Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. -Qendra polivalente. -Drejtoria e personelit. -Drejtoria e kujdesit social. -Njësia e integritetit evropian. -Personi përgjegjës për rininë.	2024 (Çdo vit)	-Numri i fushatave të zhvilluara. -Numri i pjesëmarrësve	200 000	OJF

²² Prioriteti 2.

2.1.2 Aktivitete të të rinjve vullnetarë me të moshuarit, fëmijët dhe grupe të tjera në nevojë.	-Bashkia -OJF -Ministri i shtetit për rininë dhe fëmijët.	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve të zhvilluara. -Numri i pjesëmarrësve.	100 000	OJF
2.1.3 Njohja e punës vullnetare dhe funksionimi i aplikacionit të vullnetarizmit (përgatitja e protokolleve për mënyrën e organizimit dhe menaxhimit të vullnetarizmit)	-Bashkia -OJF -Ministri i shtetit për rininë dhe fëmijët. -Qendra multifunksionale -Njësia e vlerësimit dhe referimit të nevojave.	2024 - 2027	-Numri i dokumentave dhe protokolleve të hartuar për vullnetarizmin. -Numri i të rinjve që përdorin aplikacion.	200 000	OJF

3. ÇËSHTJET SOCIALE, SHËNDETËSORE DHE SHËRBIMET PUBLIKE PËR TË RINJTË ²³

Objektivi 1: Përmirësimi i rezultateve të shëndetit fizik dhe mendor të të rinjve, duke u fokusuar në nevojat e identifikuara.

<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet/Financimi</i>	<i>Fonde/Financim nga Donator/organizata të ndryshme.</i>
3.1.1 Aktivitete që edukojnë fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre për çështje të tilla si përdorimi i alkoolit dhe drogave, ushqimi i shëndetshëm dhe siguria ushqimore.	-KVR -OJF Lokale -Profesionistë të fushës	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve. -Numri i të rinjve pjesëmarrës		OJF

²³ Prioriteti 5.

3.1.2 Promovimi i ecjes, ngarjes së biçikletave dhe aktiviteteve sportive për të përmirësuar shëndetin fizik.	- KVR - Bashkia - Qendra kulturore dhe shumë sporteve. - Drejtoria e turizmit.	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve pjesëmarrës. -Numri i të rinjve që promovojnë në mënyrë të qëndrueshme sjellje të shëndetshme.		
3.1.3 Krijimi i një grupi të rinjsh vullnetarë, edukatorë-bashkëmoshatarë pranë Bashkisë Sarandë, me qëllim që këta të fundit të ndërmarrin fushata të ndryshme sensibilizuese, ndërgjegjësuere dhe informuese për të rinjtë dhe problematikat më madhore me të cilat ata përballen.	-KVR -Bashki -OJF -Forumi rinor. -Qendra kulturore dhe shumë sporteve.	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve vullnetar. -Numëri i sensive e ndërgjegjësuese dhe informues e.		OJF
3.1.4 Aktivitete me shkollat dhe grupet rinore për të promovuar përdorimin e sigurt të teknologjisë për të rinjtë dhe prindërit.	-ZVA -KVR, Bashki -OJF	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve. - Numri i të rinjve dhe prindërve pjesëmarrës.		
Objektivi 2: Përmirësimi i rezultateve të mirëqenies emocionale të të rinjve dhe i fuqizimi të të rinjve për të kërkuar ndihmë.					
Aktivitetet/Masat	Aktorët përgjegjës	Kohëzgjatja	Treguesit	Fondet/Financimi	Fonde/Financim nga Donator/org

					anizata të ndryshme.
3.2.1 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse mbi shëndetin mendor dhe mirëqënien emocionale	-KVR -Profesionistë të fushës. -DRTSH -Qendra multifunksionale	2024 (Çdo vit)	Numri i fushatave të advokimit		OJF
3.2.2 Shërbime psiko-sociale, për të rinjtë e Sarandës, referuar nevojave të këtyre të fundit.	-KVR -Profesionistë të fushës. -Shkolla -OJF -DRTSH -Qendra multifunksional	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve. -Numri i të rinjve që kanë marr shërbimin		
4. ZBULIMI I TALENTEVE RINORE (ART, SPORT, KULTURË, MJEDIS, TURIZËM DHE TEKNOLOGJI²⁴					
Objektivi 1: Përfshirja e të rinjve në dizenjimin dhe zbatimin e aktiviteteve në fushën e artit, kulturës, sportit dhe mjedisit					
Aktivitetet/Masat	Aktorët përgjegjës	Kohëzgjatja	Treguesit	Fondet/Financimi	Fonde/Financim nga Donator/organizata të ndryshme.
4.1.1 Zbulimi i talenteve dhe më pas zhvillimi i konkurseve në fushat e muzikës, kërcimit, pikturës, skulpturës, shahut etj.	-KVR -Shkolla -Qendra Kulturore Fëmijëve -Drejtorja e Turizmit -Njesia e integrimi evropian. -Drejtorja e projekteve.	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve pjesëmarrës. -Numri i të rinjve të talentuar të zbuluar gjatë aktiviteteve.		
4.1.2 Ngritja e	-KVR	2024	-Numri i		

²⁴ Prioriteti 4.

ansamblit të të rinjve që luajnë muzikë popullore dhe valle popullore.	-Qendra Kulturore e Fëmijëve	(Çdo vit)	të rinjve pjesëmarrës. -Numri i të rinjve të talentuar të zbuluar gjatë aktiviteteve.		
4.1.3 Aktivitete për të rinjve gjatë muajve të verës.	-KVR -Qendra Kulturore e Fëmijëve	2024 (Çdo vit)	-Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës.		
4.1.4 Kampionate futbollit, basketbollit, volejbollit mes të rinjve të shkollave.	-KVR Bashkia -OJF - Drejtoria e turizmit. -Njësia e integritetit evropian. -Drejtoria e turizmit. -Drejtoria e projekte.	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve pjesëmarrës -Numri i të rinjve pjesëmarrës nga grupet vulnerable		

4.1.5 Aktivitete të ndryshme (koncerte, pastrim i qytetit, Aktivitete sportive, kinema verore, karaoke, shfaqje teatrale, etj. me të rinjtë në zonat rurale, mbjellja e pemëve etj)	Bashkia -KVR -Qendra Kulturore e Fëmijëve	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve të zhvilluara. -Numri i fëmijëve dhe të rinjve pjesëmarrës. -Numri i të rinjve pjesëmarrës nga grupet vulnerable.		
4.1.6 Aktivitet për ditën Lokale të Rinisë, Sarandë (20 Tetor)	Bashkia -KVR -OJF	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve të zhvilluara. -Numri i të rinjve pjesëmarrës.		
4.1.7 Ndarje eksperiencash midis qyteteve të ndryshme, dhe midis Sarandës dhe Ksamilit (promovimi i të rinjve dhe turizimit të qytetit)	-KVR, Bashkia -OJF -Njësia administrative Ksamil -Drejtoria e personelit	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve pjesëmarrës.		
5. ORIENTIMI PROFESIONAL, PUNËSIMI DHE SIPËRMARRJA RINORE²⁵					
Objekti 1: Zhvillimi i aftësive dhe ofrimi i mbështetjes së nevojshme për të përfunduar profilizimin, trajnimin e mëtejshëm ose integrimin në tregun e punës.					
Aktivitetet/Masat	Aktorët përgjegjës	Kohëzgjatja	Treguesit	Fondet/Financi mi	Fonde/Financim nga Donator/organizata të ndryshme.
5.1.1 Takime informuese ndërgjegjësores rreth shkollave profesionale	-ZVA KVR -Profesionistë të fushës	2024 (Çdo vit)	-Numri i seminareve.- Numri i të rinjve Pjesëmarrës.		

²⁵ Prioriteti 3.

5.1.2 Identifikimi i të rinjve që vijnë nga grupe vulnerable dhe ofrimi i mundësive që të ndjekin kurse profesionale	KVR -Shkolla -Zyrat e Punës	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve të identifikuar. -Kurse profesionale të ofruara dhe të përfunduara.		
5.1.3 Zhvillimi i praktikave profesionale pranë institucioneve të ndryshme lokale.	-Bashki -KVR -ZVA -Qendra Shëndetësore -Drejtoria e personelit.	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve që përfundojnë praktikat.		
5.1.4 Trajnime për të rinjtë mbi aftësitë në tregun e punës; sipërmarrja; edukimi për karrierën.	-Bashki -ZVA -Shkolla -Zyrat e Punës -OJF -Drejtoria e personelit.	2024 (Çdo vit)	-Numri i trajnimeve të zhvilluara. -Numri i të rinjve të Trajnuar.		
5.1.5 Kurse kodimi për të rinjtë.	-ZVA -KVR -Zyrat e Punës -OJF -Profesionistë të Fushës -Drejtoria e personelit.	2024 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve të trajnuar.		
5.1.6 Ndërmjetësimi me bizneset dhe institucionet për punësimin e të rinjve që përfundojnë kurset e ofruara.	-Bashki - -ZVA -Zyrat e Punës -Drejtoria e personelit.	2024 (Çdo vit)	- Numri i të rinjve të punësuar.		

6. PJESEMARRJA DHE PËRFAQËSIMI RINOR NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE ²⁶

Objektivi 1: 1. Rritjen e pjesëmarrjes rinore në vendimmarrje lokale nëpërmjet përfshirjes së tyre në Bordet Këshillimore të Bashkisë, shkollat dhe forumet rinore.

<i>Aktivitetet/Masat</i>	<i>Aktorët përgjegjës</i>	<i>Kohëzgjatja</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Fondet / Financimi</i>	<i>Fonde/Financim nga Donator/organizata të ndryshme</i>

6.1.1 Fushata advokacie dhe lobim me institucionet lokale, për përfshirjen e të rinjve në proceset dhe strukturat vendimmarrëse.	-ZVA -KVR -Forumi Rinor.	2024 (Çdo vit)	-Numri i aktiviteteve të zhvilluara. -Numri i pjesëmarrësve.		
--	--------------------------------	-------------------	---	--	--

6.1.2 Fushata ndërgjegjësimi dhe debate në nivel vendor për përfshirjen e komunitetit rom dhe egjiptian, si dhe personat me aftësi të kufizuara PAK, dhe grupet vulnerable, në strukturat e përfaqësimit rinor	-ZVA -KVR -Forumi Rinor.	20 24 (Çdo vit)	- Dokumentar i zhvilluar/Video promovuese.		
Objektivi 2: Rritja e kapaciteteve rinore në funksion të demokracisë dhe përfshirjen e tyre në programe të shkëmbimit ndërsektorial.					
6.2.1 Klubet e debatit duke nxitur përplasjen e ideve në mënyrë civile dhe të organizuar. (Të formojnë jo vetëm aftësi argumentuese individuale por të forcojnë njohurit dhe informacionin mbi të cilin debatohet.)	-Bashki -ZVA -KVR -Senatet e shkollave -Forumi Rinor.	20 24 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve pjesëmarrës.		
6.2.2 Seanca dëgjimore në kuadrin e “përgjegjshmërisë sociale”, do të ndikojë drejtëpërdrejtë në afrimin e politikbërësve dhe politikzbatuesve me shqetësimet e të rinjve.	-Bashkia -Këshilli Vendor Rinor (KVR) -Këshilli Bashkiak.	20 24 (Çdo vit)	-Numri i të rinjve pjesëmarrës Aktiv.		
6.2.3 Trajnime për rritjen e kapaciteteve të të rinjve që janë pjesë e KRV (qeverisja me pjesëmarrje, detyrat e Këshillit Bashkiak, etj)	-Bashkia -KVR -Drejtoria e personelit.	20 24 (Çdo vit)	-Numri i pjesëmarrësve.		
6.2.4 Fushata sensibilizuese që do të ndikojnë në rritjen e ndërgjegjësimi të të rinjve në lidhje me barazinë dhe tolerancën për çështje të ndryshme: gjini, aftësi e kufizuara, romët, grupet e marginalizuara dhe shkëmbim eksperience me bashkitë më të avancuara.	-Bashkia -Këshilli Vendor i Rinisë. -Drejtoria e kujdesit sociale. -Forumi Rinor -Njësia e Integritetit Evropian.	20 24 (Çdo vit)	-Numri i pjesëmarrësve.		

MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT VENDOR

TË VEPRIMIT

Monitorimi është një aktivitet i vazhdueshëm, i cili përfshin mbledhjen e të dhënave dhe informacionin e kërkuar për matjen e indikatorëve të përcaktuar. Monitorimi është një instrument, që do të përdoret për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara po zbatohen në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Planit Vendor të Veprimit për të Rinjtë, si dhe do të mbledhë informacionin e nevojshëm mbi arritjet dhe problematikat që mund të dalin gjatë zbatimit të këtij plani. Bashkia e Sarandës, dhe aktorët e Shoqërisë Civile do të kenë rolin kryesor në monitorimin, koordinimin dhe menaxhimin e Planit Vendor të Veprimit për të Rinjtë.

Bashkia e Sarandës do të jetë përgjegjëse për hartimin e raportit të monitorimit, i cili do të jetë një herë në vit. Ky raport do të prezantohet, diskutohet dhe analizohet me aktorë dhe grupe të ndryshme të interesit, në një seance të posaçme raportuese të organizuar nga Bashkia e Sarandës në fund të çdo viti. Në të njëjtën kohë, raportet vjetore do të jenë të hapura për Shoqërinë Civile dhe publikun, të cilët do të japin komentet dhe opinionet e tyre në lidhje me zbatimin e aktiviteteve të Planit Vendor të Veprimit për të Rinjtë.

Gjithashtu, 1 herë në 6 muaj, Përgjegjësi i Njesisë së Integritimit Evropian, pranë Bashkisë Sarandë, duhet të informojë të rinjtë, organizatat rinore dhe grupet e ndryshme të interesit mbi rezultatet e arritura në raport me aktivitetet dhe buxhetin e përdorur sipas Planit Vendor të Veprimit për të Rinjtë. Shoqëria Civile nxitet gjithashtu që të përgatisë raporte monitorimi mbi zbatimin e Planit Vendor të Veprimit.

Çdo fundvit, Përgjegjësi i Njesisë së Integritimit Evropian do të paraqesë planin e punës për vitin pasardhës, për zbatimin e Planit Vendor të Veprimit, së bashku me buxhetin respektiv. Ky buxhet i planifikuar bazuar për secilin objektiv në plan, do të marrë miratimin nga Këshilli Bashkiak dhe do të zbatohet në vitin pasardhës. Buxheti vjetor dhe plani vjetor në zbatim të këtij Plani Veprimi, përgatiten në konsultim me Këshillin Vendor Rinor, aktorët kyç të komunitetit, dhe organizatat e shoqërisë civile në Sarandë.